



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJË  
KËSHILLI BASHKIAK

NR. 2690/11 PROT

B.CURRI, 4.7.2022

V E N D I M  
Nr. 50, date 30.06.2022

“PËR

“PJESËMARRJEN E BASHKISË TROPOJË NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA  
TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT  
ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË  
UJËRAVE TË NDOTURA”

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tropojë,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” për të negociuar me bashkitë e Qarkut dhe/ose bashkitë nga qark tjeër në afërsi gjeografike si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetari të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizimeve Tropojë”, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizimeve Tropojë” për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe notarial me qëllim transfrimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SPK-UK që do të krijohet.
3. Per zbatimin e kwtij vendimi ngarkohet Kryetari I bashkisw Tropojw.
4. Ky vendim hynw nw fuqi 10 ditw pas shpallje.

Sekretar  
Ergent GJONGECAJ

Kryetar  
Shotë BASHAJ

Shpallur me 04.07.2022  
Miratuar me 15 vota  
Vota Pro 15 vota  
Vota Kunder 0 vota  
Vota Abstenim 0 vota

